



Orari i fëmijëve në Tieto Edu app, për prindërit me fëmijë në parashkollor dhe institucionin e kohës së lirë

Prindërit me fëmijë në parashkollor ose në institucionin e kohës së lirë i lënë vazhdimisht kohët aktuale të fëmijës përmes Tieto Edu app. Ti e lënë orarin për një periudhë të ardhshme kohore. Në rast të ndryshimit të orarit duhet patjetër që orari i ri të lihet mëse paku një javë paraprakisht, nuk mund të regjistrohen kohët në kuadër të kohës së shqyrtimit. Baza e orarit të fëmijës është orari i punës, studimeve dhe udhëtimeve që ndërlihdën me këtë të prindërve. Shih më tutje rregullat dhe orientimet në www.kristianstad.se/barnschema. Është shumë më rëndësi që personeli të ketë informacion lidhur me kohët e qëndrimit të fëmijës suaj në parashkollor dhe në institucionin e kohës së lirë. Kohëzgjatja prej 15 orëve për javë vendosët nga shefi i parashkollorit kur është fjala për fëmijët 3 – 5 vjeçarë në Parashkollorin e përgjithshëm dhe fëmijët e prindërve të cilët janë të lirë sipas ligjit për prindërit e lirë me leje për përkujdesje të fëmijës tjetër.

Orari i fëmijëve dorëzoji kohët aktuale

Regjistroje orarin

Në Tieto Edu app e zgjedhë ti orarin e fëmijës si dhe e regjistron orarin dhe atje shfaqet kalendari aktual për çdo javë. Ai shfaqet me një simbol kontrolli të gjelbër nëse orari është i regjistruar për atë javë. Javët pa një simbol nuk kanë orar dhe është me rëndësi që ti ta regjistrosësh orarin aktual. Nëse një ditë është e lirë e kalon ti atë ditë dhe nëse fëmija do të jetë i lirë tërë javën shenjohet kjo me shenjën përkatëse.

Është me rëndësi që ti t'i regjistrosësh kohët e orareve aktuale vazhdimisht. Nëse ti ke orar vetëm për një javë që i ka të njëjtat kohë atëherë ti i përsërit (kopjon) për një periudhë duke i zgjedhur javët aktuale. Ose ti mund t'i shenjosh të gjitha javët aktuale që do të thotë përafërsisht 4 muajt e ardhshëm. Është me rëndësi që të mos mungon orari dhe ke parasysh që ndryshimet në orar të lihen një javë paraprakisht. Kur t'a kesh kryer e shtyp sustën e konfirmimit.

Nëse ndryshohen kohët në orarin më heret të dorëzuar, atëherë ti futesh në javën aktuale e ndryshon kohën ose e shenjon të lirë dhe i konfirmon kohët.

Me rastin e konfirmimit të ndryshimeve të orarit të javëve ti vjen në faqen gjithëpërfshirëse, ku ti ke mundësi të kopjosh orarin për fëmijët të tjerë dhe t'a dërgosh orarin. Nëse është fjala për nxënës shkolle atëherë ndërroje fëmijën aktual, në mënyrë që



orari shkollor të mos përfshihet në orar. Për t'a futur kohën e mëngjesit dhe atë të pasdites përdore shenjën e plusit me rastin e kohës aktuale atëherë hapet hapësira për ta regjistruar kohën.

Nëse prindëritë banojnë në adresa të ndryshme, atëherë ata mund ta lënë secili orarin e vet. Asnjëri nga orarët e prindërve nuk dominon mirëpo sistemi i bashkon të dy oraret e prindërve në një orar të vetëm për fëmijën.

Përmbledhja

Këtu ti e shehë kohën tuaj të regjistruar të orarit (koha e planifikuar) dhe kohën në të cilën fëmija ka qenë në parashkollor ose institucionin e kohës së lirë (koha e vërtetë). Ti mund t'a shohësh atë si përmbledhje mujore ose ditë për ditë.

Personat që kanë të drejtë t'i marrin fëmijët

Është më rëndësi që ti t'i regjistrosësh personat që kanë të drejtë t'a lënë ose t'a marrin fëmijën tuaj. Informacionin e shehë personeli në parashkollor ose institucionin e kohës së lirë.

Vërejtje orari mungon

Nëse ti nuk i ke regjistruar kohët e orareve ose kohën e lirë një javë atëherë do të dërgohet vërejtje që orari mungon. Mesazhi vjen në Tieto Edu app dhe ti mund t'a instalosh në mobilin tuaj, që ai të shihet si njohtim.

Baza e orarit të fëmijës është orari i punës, studimeve dhe udhëtimeve që ndërlidhën me këtë të prindërve. Shih më tutje rregullat dhe orientimet në www.kristianstad.se/barnschema. Është shumë më rëndësi që personeli të ketë informacion lidhur me kohët e qëndrimit të fëmijës suaj në parashkollor dhe në institucionin e kohës së lirë.